



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 pika (c), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 5, 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ të KQZ-së Nr.01/2017 për Procedurën e Zëvendësimit të Anëtarit të Kuvendit Komunal, më 18.10.2017, nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **VJOLLCA RIZANI** emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga subjekti politik "Lidhja Demokratike e Kosovës- LDK" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal Vlora Dumoshin.
- II. Obligohet Kryesuesi i Kuvendit Komunal në Prishtinë, që ky vendim t'i komunikohet **Vjollca Rizanit**, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

## Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të kërkesës së Kryesuesit të Kuvendit Komunal në Prishtinë, të datës 10.10.2017, Nr.2008/2017, për zëvendësimin e anëtares të Kuvendit Vlora Dumoshit pas dorëheqjes së saj të përvokueshme nga pozita e anëtares të Kuvendit të Komunës, për arsye personale.

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatës të radhës sipas listës së rirenditur, e cila është Vjollca Rizanit, nga i njëjti subjekt politik, e gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2013, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 18.10.2017

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

**Valdete Daka**

